



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 159

Tiranë – E mërkurë, 27 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 20.11.2019	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.....	12865
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 22.11.2019	Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Ulqin, Mal i Zi.....	12867
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 26.11.2019	Për shpallje ditë zie kombëtare.....	12867
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019	Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë.....	12868
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019	Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve.....	12869
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 264, datë 21.11.2019	Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.....	12874

**VENDIM****Nr. 747, datë 20.11.2019****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 23, pika 7, e 26, pika 2, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (në vijim, Agjencia) si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile (në vijim, ministri), me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Agjencia, në përmbushje të funksioneve dhe për zbatimin e detyrave të saj, siguron fonde nga donatorë të ndryshëm, vendas e ndërkombëtarë. Në çdo rast, Agjencia njofton ministrin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për fondet e siguruar nga donatorët. Fondet e siguruar nga donatorët bëhen pjesë e buxhetit të Agjencisë.

4. Agjencia ka për mision zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie:

- a) Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë;
- b) Mbrojtja civile në nivel kombëtar;
- c) Trajnimi i vazhdueshëm i strukturave shtetërore, i subjekteve private dhe i vullnetarëve;
- c) Inspektimi i zbatimit të dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen civile në institucionet e strukturat shtetërore dhe subjektet private.

KREU II**PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË
AGJENCISË**

Agjencia ka këto përgjegjësi:

- a) Të organizojë punën për analizimin e vlerësimin e situatës së riskut nga fatkeqësitë natyrore, reduktimin e tij dhe mbrojtjen civile;

b) Të organizojë punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor, si dhe trajnimin e subjekteve private e vullnetare, nëpërmjet përgatitjes e zhvillimit të programeve të posaçme të trajnimit;

c) Të zhvillojë procesin e inspektimit, duke garantuar respektimin e dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen civile nga institucionet e strukturat shtetërore dhe subjektet private.

KREU III**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
AGJENCISË**

1. Agjencia e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet:

- a) në nivel qendror, si drejtori e përgjithshme;
- b) në nivel vendor, nga qendrat e mbrojtjes civile në qark.

2. Agjencia drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet dhe lirohet nga detyra, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

3. Qendrat e mbrojtjes civile në qark drejtohen nga titullarët e qendrave dhe raportojnë te drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore.

5. Agjencia, në përputhje me misionin, fushat e përgjegjësisë dhe përgjegjësitë e saj funksionale, përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kryen edhe detyrat, si më poshtë vijon:

a) Identifikon nevojat me qëllim përcaktimin e prioritetëve në këtë fushë, bazuar në analizën e situatës së riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel kombëtar;

b) Bashkëpunon me institucionet e strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, në nivel qendror e vendor, si dhe me organet, entet, institucionet e specializuara lidhur me plane, programe e projekte që synojnë reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

c) Identifikon e vlerëson nevojën për hartimin ose ndryshimin e legjislacionit lidhur me reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

c) Harton projektbuxhetin për realizimin e detyrave të Agjencisë, bën detajimin e buxhetit, si dhe monitoron përdorimin e fondeve përkundrejt planifikimit;

d) Komunikon me qendrat ndërkombëtare të informimit e të koordinimit të përgjigjes dhe me



shërbimet homologe, për të përballuar situatat e emergjencës civile kombëtare, në rast fatkeqësie;

dh) Aplikon projekte dhe programe me financim nga donatorë dhe organizma të huaj e vendas, i implementon ato, si dhe menaxhon programet e asistencës financiare për realizimin e veprimtarisë së saj;

e) Bashkëpunon e koordinon me institucionet dhe strukturat përkatëse qendrore e vendore për lehtësimin e procedurave doganore dhe të kalimit të kufirit, në rastet e marrjes së asistencës ndërkombëtare, për realizimin e mbështetjes së vendit pritës, në rastet kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë;

ë) Harton programe edukimi në fushën e reduktimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse që mbulon çështjet e arsimit;

f) Organizon fushata informuese/sensibilizuese për masat që duhet të merren për parandalimin e përballimin e fatkeqësive;

g) Promovon studimet dhe hulumtimet për parashikimin e parandalimin e rreziqeve natyrore ose të lidhura me veprimtarinë njerëzore;

gj) Bashkëpunon me bashkitë, prefekturat, institucionet qendrore, sektorin privat dhe organizata të ndryshme për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të realizimit të mbrojtjes civile;

h) Ndjek në vazhdimësi situatën e krijuar nga fatkeqësitë e ndryshme, për të ndërhyrë me masa, në rast të shterimit të kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse, referuar kategorizimeve të emergjencave civile sipas ligjit;

i) Bashkërendon dhe koordinon veprimet e strukturave operationale të mbrojtjes civile në nivel qendror, për përballimin e fatkeqësive kur emergjencat civile janë të rëndësishme kombëtare, me përjashtim të rasteve kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë;

j) Bashkërendon dhe koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare, në rastet e emergjencave civile kombëtare kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse;

k) Mbledh informacion nga strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, qendrore dhe vendore, për masat e marra për parandalimin e përballimin e fatkeqësive, si dhe të dhëna për dëmet e humbjet e pësuar nga këto të fundit;

l) Përgatit, çdo vit, raport drejtuar ministrit për gjendjen e përgjithshme të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

ll) I siguron Komitetit të Mbrojtjes Civile të dhënat e nevojshme për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

m) I siguron Komitetit Ndërmnishtër të Emergjencave Civile të dhënat e nevojshme për situatat

emergjente, për rreziqet që paraqesin, si dhe mundësitë për mbështetje materiale të operacioneve për përballimin e emergjencave civile.

6. Qendrat e mbrojtjes civile në qark (në vijim, QMCQ) janë struktura në varësi të Agjencisë, nën drejtimin e drejtorit të Përgjithshëm të saj, me seli në çdo qark, dhe përbëjnë rrjetin institucional të specializuar, që zbatojnë detyrat për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në qark.

QMCQ-ja kryen edhe detyrat, si më poshtë vijon:

a) Zbaton detyrat e Agjencisë bazuar në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, si dhe kryen të gjitha detyrat e deleguara nga Agjencia në qark për çështjen e mbrojtjes civile;

b) Koordinon veprimtarinë në bazë rajoni me të gjithë drejtuesit e pushtetit vendor për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë;

c) Mbikëqyr hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;

ç) Grumbullon e përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë për zbatimin e detyrave të planëzimit dhe të përballimit të emergjencave civile;

d) Realizon organizimin, bashkërendimin dhe koordinimin e forcave operationale.

7. Autoritetet publike, funksionet e të cilave kanë ose mund të kenë ndikim në çështjet e reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, informojnë Agjencinë për politikat dhe objektivat e tyre për këto çështje.

8. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë në nivel qendror dhe vendor rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve administrativë të Agjencisë në nivel qendror dhe vendor rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

9. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

10. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emërtimi i ministrisë nga varet Agjencia), Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

11. Qendrat e mbrojtjes civile në qark kanë stemat, logot dhe vulat e tyre zyrtare. Stemat përbëhen nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emërtimi i ministrisë nga varet Agjencia), Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Qendra e Mbrojtjes Civile për qarkun ... (emri i qarkut ku ka selinë qendra)”, në përputhje me



përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

12. Vula e Agjencisë dhe vula e secilës qendër të mbrojtjes civile në qark kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për nëpunësit civilë aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

2. Punonjësit, zyrat, ambientet e punës, mjetet, pajisjet, dokumentacioni dhe fondet buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, struktura aktuale vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

4. Vendimi nr. 532, datë 1.8.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministri përgjegjës për mbrojtjen civile dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 748, datë 22.11.2019

PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ULQIN, MAL I ZI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Ulqin, Mal i Zi.

2. Shpenzimet për hapjen e këtij posti konsullor të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 749, datë 26.11.2019

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, dhe në vijim të pikës 12, të kapitullit VI, të Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare ditën e mërkurë, datë 27.11.2019, në nderim të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë dhe në orën 12:00 të mbahet një minutë heshtje.

3. Ngarkohen të gjithë institucionet shtetërore dhe publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr.750, datë 27.11.2019****PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË
FATKEQËSISË NATYRORE NË
QARQET DURRËS DHE TIRANË**

Në mbështetje të neneve 100, 170 e 174 të Kushtetutës, dhe të neneve 18, shkronja “ç”, 19 e 39, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Krijimin e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile (KNEC), si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.

3. KNEC-ja kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje anëtarët, si më poshtë vijon:

- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Infrastrukturs dhe Energjisë;
- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Prefektin e Qarkut Durrës;
- Prefektin e Qarkut Tiranë.

4. Në mbledhjet KNEC-së marrin pjesë me kërkesë të Kryetarit përfaqësues të organeve të ndryshme publike, të biznesit, ekspertë/profesionistë të fushës së mbrojtjes civile dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose drejtues të OJF-ve, me objekt veprimtarie mbrojtjen civile dhe ndihmën humanitare.

5. Mbledhjet e KNEC-së, në mungesë të Kryetarit, me autorizim të tij, drejtohen nga një funksionar i lartë shtetëror.

6. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KNEC-së.

7. Për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë merren masat e jashtëzakonshme, si më poshtë:

7.1. Institucionet publike:

a) të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;

b) të përdorin burimet financiare të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe të rivlerësojnë buxhetin e tyre vjetor, në përputhje me kryerjen e shpenzimeve shtesë të parashikuara;

c) të vënë në dispozicion burimet njerëzore dhe logjistike;

ç) të caktojnë objektet shtetërore në përgjegjësinë e tyre të administrimit, që mund të vihen në dispozicion për strehimin e popullsisë së evakuuar;

d) të marrin masa të tjera që ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë;

dh) përjashtëmish, procedurat e prokurimit për mbulimin e nevojave emergjente, si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor t'i zhvillojnë në rrugë shkresore;

e) ministritë të ngrenë grupe pune, për koordinimin e ndihmave me strukturat e mbrojtjes civile.

7.2. Strukturat operacionale të sistemit të mbrojtjes civile:

a) të vendosin dhe të zbatojnë masa të veçanta për garantimin dhe rritjen e sigurisë së shtetasve në zonat e prekura nga fatkeqësia;

b) të aktivizojnë dhe të organizojnë procedura të evakuimit për popullsinë e rrezikuar;

c) të organizojnë kontrolle të njëanëshme ose në bashkëpunim me komunitetin të banesave dhe objekteve private për gjetjen e të mbijetuarve dhe të viktimave të fatkeqësisë, si dhe procedurat e detyruara për kryerjen e shërbimeve funerale.

7.3. Subjektet private

a) të respektojnë procedurat dhe masat për evakuimin dhe strehimin e të evakuuarve;

b) të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë;

c) të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;

ç) të mbyllin përkohësisht veprimtaritë e tyre, si dhe të kryejnë shërbime të ndryshme në funksion të përballimit të fatkeqësive, apo dhe të prodhojnë artikuj të emergjencës, për të cilat do të kompensohen nga buxheti i shtetit sipas marrëveshjeve;

d) të mos vjelin tarifat e kalimit rrugor për mjetet e angazhuara në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.



7.4. Shtetasit:

a) të zbatojnë urdhrat, masat dhe udhëzimet e autoriteteve të mbrojtjes civile, si dhe të ndjekin procedurat e kërkuara, në mënyrë të veçantë për evakuimin;

b) të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë;

c) të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

8. Për procedurat, afatet dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve do të zbatohen rregullat e përcaktuara në vendimin nr.329, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

9. Kompensimi i subjekteve për pasuritë e dëmtuara nga tërmeti do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohen ministrat dhe institucionet e përmendura në pikën 3 për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 263, datë 21.11.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PLOTËSUESE TË VLERËSIMIT
TË GJYQTARËVE

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 68–72, 74–78, 84–95, 97 dhe 171, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 25, të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 96/2016”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas tekstit që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

RREGULLA PLOTËSUESE TË
VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky vendim zbatohet për vlerësimin e gjyqtarëve të caktuar në një pozicion në gjykatë, të cilët kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Këto rregulla nuk zbatohen për vlerësimin etik dhe profesional, të:

a) kryetarit të gjykatës;

b) anëtarit gjyqtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kohën që ai ushtron këtë funksion;

c) gjyqtarit në skemën e delegimit ose të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose në Gjykatën e Lartë.

Rregullat që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të këtyre subjekteve miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Këto rregulla nuk zbatohen për gjyqtarin e komanduar në strukturat të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 2, i cili ruan statusin e magjistratit. Veprimtaria e tij vlerësohet nga vetë institucioni, sipas sistemit të vlerësimit të strukturës përkatëse, ku është komanduar.



Neni 3 Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Dosja e vlerësimit” është dosja e hapur për secilin gjyqtar që përmban dokumentet e listuara në nenin 90 të ligjit për statusin;

b) “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor;

c) “Kryetari” është kryetari i gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar detyrën gjatë periudhës së vlerësimit;

ç) “Komisioni” është Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill;

d) “Ligji për statusin” është ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

dh) “Nëpunësi përgjegjës për vlerësimin” është pjesëtari i njësisë mbështetëse të Komisionit, i ngarkuar me përgatitjen e akteve në dobi të procesit të vlerësimit;

e) “Raporti analitik” është akti që hartohet nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit;

ë) “Relatori” është anëtari i Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill dhe/ose anëtari zëvendësues, i caktuar me short për çdo vlerësim;

f) “Projektraporti i vlerësimit” është akti i hartuar nga relatori që përmban, për secilin gjyqtar, të dhënat dhe informacionet sipas nenit 93 të ligjit për statusin, analizën e tyre dhe propozimin për nivelin e vlerësimit;

g) “Vlerësim i përshpejtuar me kërkesë” është vlerësimi që kryhet në zbatim të nenit 97 të ligjit për statusin;

gj) “Vlerësim i përshpejtuar i detyruar” është vlerësimi që kryen Këshilli në periudhën kalimtare, sipas nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”.

Neni 4 Parimet e vlerësimit

Vlerësimi i gjyqtarëve bazohet dhe zbatohet nëpërmjet parimeve të pavarësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit.

Neni 5 Periudha e vlerësimit

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të ligjit për statusin.

2. Periudha e lejes së papaguar nuk llogaritet si përvojë profesionale për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit.

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre- ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.

Neni 6 Mënyra e vlerësimit

1. Vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarit kryhet sipas kriterëve të vlerësimit, të matura nga treguesit përbërës sipas metodologjisë së pikëzimit të miratuar nga Këshilli, pjesë përbërëse e skemës së vlerësimit.

2. Standardet e nevojshme për matjen e treguesve ligjorë miratohen me vendim të veçantë të Këshillit. Standardet matëse zbatohen duke individualizuar pozicionin e gjyqtarit në gjykatë, lidhur me shkallën, juridiksionin, degën e gjykatës dhe përkatësinë në seksion gjykimi.

3. Nëse gjyqtari ka ushtruar detyrën në pozicione të ndryshme brenda një viti kalendarik, aplikohen standardet matëse të vlerësimit të lidhura me pozicionin ku gjyqtari ka ushtruar më gjatë detyrën.

4. Vlerësimi etik dhe profesional ndjek me rigozitet rregullin e formalizimit, duke dokumentuar me shkrim çdo veprim që kryhet, i cili më pas përfshihet në dosjen e vlerësimit.

Neni 7 Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar

Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një gjyqtari, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet



përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar.

Neni 8

Roli i relatorit

1. Relatori është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, dhe merr masat e mëposhtme për:

a) njoftimin e gjyqtarit dhe kryetarit për fillimin e procedurës së vlerësimit;

b) mbledhjen e dokumentacionit të vlerësimit, duke bashkëpunuar dhe komunikuar me gjyqtarin, kryetarin e gjykatës dhe çdo institucion tjetër;

c) mbikëqyrjen e krijimit të dosjes së vlerësimit dhe të përgatitjes së raportit analitik;

ç) njoftimin e kryetarit të Komisionit për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjen e raportit analitik;

d) hartimin e projektraportit të vlerësimit të gjyqtarit.

2. Në kryerjen e funksioneve të tij, relatori mbështetet nga struktura administrative e Këshillit.

Neni 9

Roli i Komisionit

Pas krijimit të dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik, Komisioni vlerëson nëse dokumentacioni i dosjes së vlerësimit është i plotë e mund të vijohet me hartimin e projektraportit të vlerësimit, ose i kërkon relatorit marrjen e të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, duke i përcaktuar ato.

KREU II

PROCEDURA E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL

Neni 10

Fazat e vlerësimit

Vlerësimi etik dhe profesional zhvillohet sipas fazave të mëposhtme:

a) veprimet paraprake, të cilat përfshijnë hartimin, miratimin dhe publikimin e programit vjetor të vlerësimeve, caktimin e relatorit dhe të nëpunësit përgjegjës për çdo vlerësim;

b) mbledhja e dokumentacionit dhe krijimi i dosjes së vlerësimit nga nëpunësi përgjegjës nën mbikëqyrjen e relatorit;

c) hartimi i raportit analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin;

ç) shqyrtimi i plotësimit të procedurave të vlerësimit nga Komisioni;

d) hartimi i projektraportit të vlerësimit nga relatori;

dh) miratimi i projektraportit të vlerësimit nga Këshilli.

Neni 11

Programi i vlerësimit

1. Me propozim të Komisionit, Këshilli miraton brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.

2. Në përgatitjen e projektprogramit, Komisioni mbështetet nga njësi e burimeve njerëzore. Kjo njësi, brenda muajit shtator, i paraqet Komisionit listën emërore të gjyqtarëve, të përditësuar me të dhënat e mëposhtme:

a) vjetërsia në punë e secilit gjyqtar;

b) pozicioni i gjyqtarit;

c) perioda për të cilën gjyqtarit i është bërë vlerësimi i fundit;

d) çdo të dhënë tjetër që Komisioni e vlerëson të nevojshme për qëllim të hartimit të programit.

3. Projektprogrami hartohet bazuar në parimin e kryerjes së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në kohën e duhur. Lista e gjyqtarëve përfshin detyrimisht të gjithë gjyqtarët të cilëve u ka përfunduar ose u përfundon perioda e vlerësimit në vitin përkatës.

4. Vendimi që miraton programin publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

5. Brenda muajit janar kryetarët e gjykatave dërgojnë në Këshill të dhënat statistikore sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli, për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimit. Bashkë me të dhënat statistikore, kryetari dërgon në Këshill informacionin lidhur me dhomën dhe seksionin ku gjyqtari ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit.

6. Një kopje e të dhënave statistikore individuale të përcjella në Këshill i dorëzohet njëkohësisht edhe gjyqtarit subjekt vlerësimi.



Neni 12

Caktimi i relatorit

1. Para fillimit të çdo tremujori, Këshilli me propozim të Komisionit përcakton listën e gjyqtarëve që i nënshtrohen vlerësimit sipas programit të miratuar.

2. Bazuar në listën e mësipërme, mbledhja plenare e Këshillit cakton me short relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës. Për shkak të ngarkesës së punës dhe kur Komisioni e çmon të nevojshme, në shortin për zgjedhjen e relatorit përfshihen edhe anëtarët zëvendësues.

3. Relatori i njofton gjyqtarët fillimin e procedurës së vlerësimit sipas nenit 85, pika 2, të ligjit për statusin, emrin e nëpunësit përgjegjës, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre.

4. Në rast se gjyqtari paraqet kërkesë për përjashtimin e relatorit apo të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, Këshilli vendos jo më vonë se tri ditë nga depozitimi i saj. Nëse relatori i çështjes ose nëpunësi përgjegjës për vlerësimin përjashtohet, Këshilli zhvillon menjëherë procedurat e shortit për caktimin e një relatori ose nëpunësi përgjegjës të ri.

5. Njoftimi për fillimin e procedurës së vlerësimit i dërgohet edhe kryetarit dhe kancelarit të gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar detyrën gjatë periudhës së vlerësimit.

Neni 13

Mbledhja e dokumentacionit dhe krijimi i dosjes së vlerësimit

1. Brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurës së vlerësimit, gjyqtari përgatit aktin e vetëvlerësimit sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli, dhe ia dorëzon atë kryetarit të gjykatës ku ka ushtruar funksionin.

2. Brenda dy muajve nga marrja e njoftimit nga relatori, kryetari zhvillon procedurën sipas nenit 87 të ligjit për statusin, jep mendimin sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli, si dhe i dërgon aktet e vlerësimit Këshillit. Aktet e vlerësimit që dërgohen nga kryetari përcaktohen në nenin 88, pika 2 të ligjit për statusin.

3. Bazuar në të dhënat statistikore, relatori përcakton seksionin ku gjyqtari ka ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet

vlerësimi dhe, në vartësi të numrit të çështjeve për secilën kategori, përcakton në mënyrë proporcionale, sipas kriterëve të vendosura në nenin 91 të ligjit për statusin, numrin e çështjeve që do të përzgjidhen.

4. Data e zhvillimit të shortit përcaktohet nga relatori dhe i njoftohet kryetarit dhe kancelarit të gjykatës përkatëse. Shorti zhvillohet me praninë e detyrueshme të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

5. Për aq sa është e mundur, shorti realizohet në mënyrë elektronike, sipas procedurës së miratuar me vendim të veçantë të Këshillit.

6. Zhvillimi i shortit dokumentohet me procesverbal sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.

Neni 14

Dosja e vlerësimit

1. Relatori, brenda dy javëve nga paraqitja e akteve të vlerësimit prej kryetarit sipas nenit 88 të ligjit për statusin, merr masat për krijimin e dosjes së vlerësimit. Gjyqtari ka të drejtë në çdo kohë të marrë kopje apo ekstrakte të akteve të përditësuara.

2. Në dosjen e vlerësimit, veç akteve dhe informacioneve të parashikuara në nenet 90 dhe 92 të ligjit për statusin, përfshihen edhe informacione nga institucione të tjera audituese ose kontrolluese, të cilat kërkojnë kur çmohet e nevojshme.

3. Brenda dy javëve nga krijimi i dosjes së vlerësimit, nëpunësi përgjegjës, nën mbikëqyrjen e relatorit, harton raportin analitik sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli. Raporti analitik përmban listën e akteve të mbledhura në procesin e vlerësimit, si dhe analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat nga aktet e dosjes së vlerësimit.

Neni 15

Hartimi i projektraportit të vlerësimit

1. Brenda një muaji nga paraqitja e akteve prej kryetarit të gjykatës dhe pasi Komisioni i ka vlerësuar të plota procedurat, relatori harton projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional, sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli.

2. Projektraporti i hartuar nga relatori i njoftohet gjyqtarit, i cili informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe për ta



kundërshtuar atë me shkrim brenda 2 javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 94 të ligjit për statusin.

3. Gjyqtari ka të drejtë të dëgjohej nga Këshilli në mbledhjen plenare në të cilën do të shqyrtohet projektraporti i vlerësimit.

Neni 16

Shqyrtimi i vlerësimit dhe vendimi i Këshillit

1. Projektraporti i vlerësimit përcillet për shqyrtim nga relatori i mbledhjes plenare. Si rregull, çështja përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit.

2. Çdo anëtar i Këshillit ka akses në dosjen e vlerësimit.

3. Nëse gjyqtari nuk ka kërkuar të dëgjohej nga Këshilli, çështja shqyrtohet bazuar në relatin e çështjes nga relatori, i cili i përgjigjet edhe pyetjeve eventuale nga anëtarët e Këshillit.

4. Nëse gjyqtari ka kërkuar të dëgjohej, çështja shqyrtohet bazuar në relatin e çështjes nga relatori dhe në shpjegimet e gjyqtarit, i cili gjatë dëgjësës nuk duhet të përsërisë përmbajtjen e kundërshtimit me shkrim. Çdo anëtar i Këshillit mund të bëjë pyetje për relatorin dhe gjyqtarin. Me kërkesë të gjyqtarit, ose për shkak të nevojës për të sqaruar faktet, Këshilli thërret në seancë dëgjimore edhe persona të tjerë.

5. Këshilli vendos për vlerësimin sipas rregullave të nenit 95 të ligjit për statusin.

6. Në përfundim, Këshilli publikon në faqen zyrtare të internetit ekstrakte të raportit të vlerësimit dhe të vendimit, sipas formës standarde të miratuar prej tij.

KREU III

VLERËSIMI I PËRSHPEJTUAR

Neni 17

Rastet e vlerësimit të përshpejtuar

1. Vlerësimi i përshpejtuar bëhet vetëm me kërkesë me shkrim të gjyqtarit, kur ai kërkon:

- a) të transferohet;
- b) të ngrihet në detyrë.

2. Këshilli vendos fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar për periudhën që përfshin vitin e fundit kalendarik, vetëm nëse

veprimtaria profesionale dhe etike e gjyqtarit nuk është vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike.

3. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe, vlerësimi i përshpejtuar realizohet, për aq sa është e mundur, sipas rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të caktuara nga ligji për statusin dhe nga ky vendim.

Neni 18

Rregulla të veçanta

1. Këshilli miraton program të veçantë për gjyqtarët që vlerësohen me procedurë të përshpejtuar. Bashkë me miratimin e programit, Këshilli, zgjedh relatorin dhe nëpunësin përgjegjës dhe njofton gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës për fillimin e procedurës. Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i programit relatori njofton kryetarin për dërgimin e të dhënave statistikore për vitin e vlerësimit.

2. Brenda dy javëve nga marrja e njoftimit të relatorit, gjyqtari përgatit aktin e vetëvlerësimit sipas formës standarde.

3. Brenda një muaji nga marrja e njoftimit të relatorit, kryetari zhvillon procedurën sipas nenit 87 të ligjit për statusin, jep mendimin sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli, si dhe i dërgon aktet e vlerësimit Këshillit. Aktet e vlerësimit që dërgohen nga kryetari përcaktohen në nenet 88, pika 2 dhe 97, pika 3 të ligjit për statusin.

4. Relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin marrin masa për mbledhjen e akteve, krijimin e dosjes së vlerësimit, si dhe për hartimin e raportit analitik dhe të projektraportit të vlerësimit në një kohë sa më të shpejtë dhe në çdo rast, jo më vonë se dy muaj nga paraqitja e akteve të vlerësimit prej kryetarit të gjykatës.

5. Projektraporti i vlerësimit i njoftohet gjyqtarit dhe përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit.

6. Viti kalendarik për të cilin gjyqtari është vlerësuar në mënyrë të përshpejtuar përjashtohet nga periudha e vlerësimit periodik.



KREU IV PËRFUNDIMI I VLERËSIMIT

Neni 19

Ankimi i gjyqtarit

1. Kundër vendimit të Këshillit, gjyqtari ka të drejtën e ankimit vetëm për shkelje të rënda procedurale.

2. Ankimi paraqitet në Gjykatën e Apelit Administrativ brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar të Këshillit.

Neni 20

Arkivimi i dosjes së vlerësimit

1. Kur vlerësimi i gjyqtarit bëhet përfundimtar, rezultati i vlerësimit përfshihet në dosjen personale të gjyqtarit.

2. Dosja e vlerësimit arkivohet sipas rregullave të përgjithshme për arkivimin e akteve të Këshillit.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE

Neni 21

Periudha e rivlerësimit kalimtar

1. Periudha e rivlerësimit kalimtar 8.10.2013–8.10.2016 do të konsiderohet periudhë vlerësimi periodik i cili përfundon me përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e çdo gjyqtari që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Për këtë periudhë, aftësia organizative e gjyqtarit do të vlerësohet duke iu referuar kriterëve matëse të veprimtarisë gjyqësore sipas aneksit 1 të vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nr. 261/2, 14 prill 2010.

2. Periudha 2013–2016 konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi për gjyqtarët që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar. Nga data 1 janar 2017, Këshilli llogarit periudhën e vlerësimit të individualizuar për çdo gjyqtar sipas nenit 84 të ligjit për statusin.

3. Deri në përfundimin e rivlerësimit kalimtar, programi vjetor i vlerësimit etik dhe profesional merr në konsideratë rastet, për të cilat organet e rivlerësimit kalimtar kanë paraqitur dosjet e rivlerësimit profesional kalimtar në Këshill sipas nenit 171, pika 5 të ligjit për statusin.

4. Si burime vlerësimi për të përcaktuar nivelin e vlerësimit të gjyqtarit, shërbejnë të dhënat që përfshihen në dosjen e vlerësimit të gjyqtarit të dërguara nga organet e rivlerësimit kalimtar, si dhe 6 dosje shtesë të përzgjedhura me short për vlerësim sipas rregullave të miratuara nga Këshilli.

Neni 22

Rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare

1. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25, të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përsheptuar të detyruar të gjyqtarit.

2. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përsheptuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara në nenin 18 të këtij vendimi.

Neni 23

Hartimi i programit të vlerësimit në periudhën kalimtare

1. Deri sa të sigurohet zbatimi në kohën e duhur i vlerësimit etik dhe profesional, paralelisht me vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve sipas nenit 84 të ligjit për statusin, Këshilli në programin vjetor të vlerësimit, i jep përparësi rasteve të mëposhtme:

a) përfundimit në kohën e duhur të vlerësimit etik dhe profesional për përcaktimin/gradimin e nivelit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas nenit 21 të këtij vendimi;

b) përfundimit të vlerësimeve të përsheptuara të detyruara sipas nenit 22 të këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 264, datë 21.11.2019

PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË GJYQTARIT”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 68–72, 74–78, 84–95, 97 dhe 171, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i



ndryshuar, nenin 25, të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË GJYQTARIT

1. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjor, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritat e gjyqtarit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjyqtarit.

2. Metodologjia e pikëzimit është pjesë përbërëse e “Skemës së vlerësimit”, sipas përcaktimeve të nenit 2, shkronja “ll”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, pikëzimi bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuar në nenet 68–72, 74–78, 84–95 dhe 97, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për aq sa ligji e lejon, përcaktimi i treguesve shtesë të çdo kriteri vlerësues dhe pesha specifike e tyre bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie.

5. Vlerësimi i gjyqtarit kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësitë profesionale të gjyqtarit;
- b) aftësitë organizative;

c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit;

ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

6. Vlerësimi i gjyqtarit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret;

b) vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “Shumë mirë” për tre kriteret dhe “Mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”;

c) vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “i Pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të vlerësohen të paktën “Mirë”;

d) vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste:

i. kur magjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;

ii. kur magjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast niveli i përgjithshëm i vlerësimit, nuk mund të jetë më i lartë, se niveli i vlerësimit për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”.

Niveli i vlerësimit të gjyqtarit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit.

8. Niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.

9. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:

- a) 90 deri 100 pikë “Shkëlqyeshëm”;



- b) 70 deri 89 pikë “Shumë mirë”;
- c) 50 deri në 69 pikë “Mirë”;
- d) 30 deri në 49 pikë “Mjaftueshëm” dhe;
- e) 1 deri në 29 pikë “Pamjaftueshëm”.

10. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve sipas rëndësisë së çdo treguesi (indikatori) vlerësimi, duke shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

11. Në tabelën e pikëzimit përcaktohet ndarja e kriterëve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të gjyqtarit.

1. AFTËSITË PROFESIONALE (100 pikë)

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë);

b) Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes (25 pikë).

B. Arsytimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit (15 pikë);

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit (10 pikë);

c) Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (25 pikë).

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE (100 pikë)

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)

a) Respektimi i afateve ligjore (15 pikë);

b) Plotësimi i standardeve minimale kohore (5 pikë);

c) Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje (5 pikë);

ç) Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore (10 pikë);

d) Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor (15 pikë).

B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore (35 pikë)

a) Numri mesatar i seancave gjyqësore dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive (15 pikë);

b) Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor (20 pikë).

C. Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore (15 pikë)

a) Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes (5 pikë);

b) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes (10 pikë).

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

B. Integriteti (40 pikë)

a) Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

C. Paanësia (25 pikë)

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë);

b) Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit (15 pikë).

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

A. Aftësitë e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera, të tretët (25 pikë);

b) Respektimi i konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë).

B. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (25 pikë)

a) Komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale me ta (15 pikë);

b) Komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore (10 pikë).

C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë);

b) Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve (5 pikë);

c) Pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me median dhe publikun të gjykatave (5 pikë);

ç) Publikimet ligjore akademike (5 pikë).



PËRKUFIZIMET

Përkufizime të nevojshme për t'u mbajtur parasysh, me qëllim vlerësimin e gjyqtarit sipas kësaj metodologjie:

1. “Çështje pa palë ndërgjyqëse”, nënkupton çdo çështje të regjistruar në gjykatë, e paraqitur në formën e kërkesës, me të cilën nuk kërkohet zgjidhja në themel e një mosmarrëveshjeje. Në këto çështje përfshihen çështjet civile dhe çështjet administrative pa palë kundërshtare, çështjet administrative-penale dhe masat e sigurimit.

2. “Ditë” janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune;

3. “Gjyqtar relator” është gjyqtari i caktuar me short në cilësinë e relatorit të trupit gjykues për gjykimin e një çështjeje gjyqësore;

4. “Standardet minimale të afatit” janë afate orientuese të miratuara nga KLGJ-ja, brenda të cilave një çështje duhet të përfundojë. Standardet minimale të afatit janë të rishikueshme dhe përcaktohen në mënyrë të veçantë për lloje të ndryshme çështjesh, duke vlerësuar natyrën, kompleksitetin dhe sasinë e çështjeve të regjistruara në gjykatë, si dhe infrastrukturën e gjykatës;

5. “Dokumente ligjore” janë dokumentet e hartuara dhe të dorëzuara nga gjyqtari, që shërbejnë për vlerësimin e tij.

1. AFTËSIA PROFESIONALE E GJYQTARIT (100 pikë)

Për të pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtëm të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi.

Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë aftësi të gjyqtarit, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari, formularin e vetëvlerësimit, si dhe në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.

Vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar faktet e çështjes, identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

b) Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes (25 pikë)

Për të pikëzuar aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar ligjin, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari, formularin e vetëvlerësimit, si dhe në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, në të cilat vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin e identifikuar dhe arsytimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi. Vetëm referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit, mund të jetë tregues i një mungese të aftësive për të interpretuar ligjin.

Vlerësohet, gjithashtu, aftësia e gjyqtarit për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, pavarësisht përmendjes së tyre shprehimisht në vendim.

Brenda këtij treguesi vlerësohet gjithashtu aftësia e gjyqtarit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar. Vlerësohet sa dhe si gjyqtari identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendas dhe nga sisteme të tjera. Në veçanti, vlerësohet nëse gjyqtari i referohet dhe menaxhon me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit: praktikën e konsoliduar gjyqësore; praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë; praktikën gjyqësore të



Gjykatës Kushtetuese; GJEDNJ-së dhe të gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës, por i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit (15 pikë)

Ky tregues pikëzohet referuar qartësisë, koncizitetit dhe lehtësisë në kuptueshmëri dhe lexueshmëri, të dokumenteve ligjorë të dorëzuar nga gjyqtari dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short. Vlerësohet: përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ð), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit (10 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse dokumentet ligjorë të dorëzuar nga gjyqtari dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short përmbajnë një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, të cilës gjyqtari i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së

tyre me konkluzionet e arritura. Në veçanti, vlerësohet ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

c) Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e gjyqtarit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti, në dokumentet ligjorë të dorëzuar nga gjyqtari dhe në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, vlerësohet nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor dhe nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT (100 pikë)

Megjithëse përgjegjësitë e gjyqtarit ndryshojnë midis juridiksioneve dhe roleve specifike, gjyqtari në çdo nivel dhe në çdo detyrë duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Gjyqtari nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij/saj, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.



Gjyqtari duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e seancave gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegjie.

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)

a) Respektimi i afateve ligjore (15 pikë)

Respektimi i afateve ligjore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve të parashikuara në ligj brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i një çështjeje. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat. Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Të dhënat në përqindje ekuivalentohen në pikë sipas tabelës së pikëzimit.

Jashtë afatit	Nr. i pikëve
Mbi 40%	3
31–40%	6
21–30%	9
11–20%	12
0–10%	15

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme deri në pikëzimin maksimal.

b) Plotësimi i standardeve minimale kohore (5 pikë)

Plotësimi i standardeve minimale kohore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese të përcaktuara nga KLGJ-ja, për çdo kategori çështjesh. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi. Si burim vlerësimi shërbejnë të

dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Për efekt të këtij vlerësimi, pikëzimi i gjyqtarit fillon nga pragu i përqindjes maksimale të çështjeve të gjykuara përtej standardeve minimale kohore, i përcaktuar nga KLGJ-ja.

Të dhënat në përqindje ekuivalentohen në pikë sipas tabelës së pikëzimit.

Referuar standardeve CEPEJ	
Jashtë afatit	Nr. i pikëve
Mbi 10%	1
Mbi 8–10%	2
Mbi 6–8%	3
Mbi 4–6%	4
0–4%	5

Referuar vendimit të KLD	
Jashtë afatit	Nr. i pikëve
Mbi 40%	1
Mbi 30–40%	2
Mbi 20–30%	3
Mbi 10–20%	4
0–10%	5

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.

c) Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje (5 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje nga ana e gjyqtarit krahasohet me standardet minimale kohore të përcaktuara nga KLGJ-ja për çdo kategori çështjesh. Pikëzimi bëhet referuar standardeve minimale kohore, sipas llojit të çështjeve. Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi. Koha mesatare përcaktohet më vete për secilën kategori çështjesh.



Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Koha mesatare	Nr. i pikëve
Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve	1
Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	2
Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve	3
Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	4
Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.

ç) Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore (10 pikë)

Rendimenti i përfundimit të çështjeve është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik. Për të pikëzuar këtë tregues, Këshilli i referohet rendimentit të përfundimit të çështjeve (i shprehur si përqindje).

Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Tej standardit	Nr. i pikëve
Nën 81%	2
Mbi 81–87%	4
Mbi 87–93%	6
Mbi 93–99%	8
+99%	10

(Tabela e statistikave CEPEJ për vitin 2018 tregon se CR për çështjet civile, penale dhe administrative ishte rreth 80%.)

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

d) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor (15 pikë)

“Koha mesatare e vendimit gjyqësor” vlerëson aftësinë e gjyqtarit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore. Ky është treguesi mesatar i kohës për arsyetimin e të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit të vendimit në sekretari.

Treguesi mesatar i kohës për arsyetimin e të gjitha vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh krahasohet me afatin procedural të parashikuar në ligj dhe pikëzohet sipas tabelës së mëposhtme.

Koha mesatare	Nr. i pikëve
Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	3
Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	6
Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve	9
Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	12
Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15



Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore (35 pikë)

a) Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive (15 pikë)

Treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimin), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, duke kryer me eficiencë veprime, të tilla si:

- mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit;
- marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse;
- planifikimi i seancave, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjes, afatet ligjore dhe mendimin e palëve;
- si edhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave joproductive.

Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme.

Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë	3
Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë	9
1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15

b) Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor (20 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse gjyqtari kryen me eficiencë veprime, si p.sh.:

- vënia në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore;
- kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklarates së mbrojtjes;
- planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive;
- dokumentimi i vendimeve dhe i veprimeve të tjera procedurale;
- drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre;
- fillimi i seancave pa vonesë;
- regjistrimi audio i seancave;
- ndjekja me rigoroze të fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor;
- orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	4
Nën mesataren	8
Mesatare	12
Mbi mesataren	16
Shumë e lartë	20



Vlerësuesi përqendrohet në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, në vlerësimin e kryer nga gjyqtari dhe në mendimin e kryetarit.

C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore (15 pikë)

a) Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes (5 pikë)

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet dhe pikëzohet në bazë të renditjes së akteve të dosjes gjyqësore në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, bazuar në udhëzimet e KLGJ-së.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	1
Nën mesataren	2
Mesatare	3
Mbi mesataren	4
Shumë e lartë	5

Vlerësuesi përqendrohet në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short dhe në vlerësimin e kryer nga gjyqtari.

b) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes (10 pikë)

Treguesi i saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit vlerësohet dhe pikëzohet, duke mbajtur parasysh aftësinë e gjyqtarit për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i duhuri dhe t'i përkasë çështjes konkrete.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

Vlerësuesi përqendrohet në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short dhe në vlerësimin e kryer nga gjyqtari.

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi, bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga KLGJ-ja, të cilat interpretohen në përputhje me Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe komentari përkatës,¹ si edhe parimet për etikën gjyqësore të përpunuara nga Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësore (ENCJ).²

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

Etika në punë, me qëllim vlerësimin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, nënkupton sjelljen e kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme.

Përmbytja e këtij detyrimi profesional kërkon që gjyqtari në ushtrimin e detyrës duhet të tregojë dhe të provojë se në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi, shmang çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

¹ UNODC, Komentari për Parimet themelore të Bangalorit për Etikën Gjyqësore, Shtator 2007, https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf

² Raporti për etikën gjyqësore i grupit të punës së ENCJ-së, 2009-2010, <https://www.ency.eu/images/stories/pdf/ethics/judiciaethicsdeontologiefinal.pdf>



Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	7
Nën mesataren	14
Mesatare	21
Mbi mesataren	28
Shumë e lartë	35

Vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, në vlerësimin e kryer nga gjyqtari dhe në mendimin e kryetarit.

B. Integriteti i gjyqtarit (40 pikë)

a) Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)

Integriteti i gjyqtarit, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të tij, nënkupton imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi dhe presioni të jashtëm në ushtrimin e detyrës.

Parimet e Bangalorit parashtrojnë se nuk ka shkallë integriteti të përkufizuara si të tilla. Integriteti është një karakteristikë që gjyqtari e ka ose nuk e ka. Integriteti është absolut. Në gjyqësor, integriteti është më shumë se një virty; është një domosdoshmëri.

Prandaj, në përputhje me rrethanat, në caktimin e pikëve në dispozicion sipas këtij indikator, Këshilli mund të marrë në konsideratë opsionet që vijojnë:

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se gjyqtarit i mungon integriteti, Këshilli do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme;

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion që tregojnë se gjyqtarit i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të gjyqtarit dhe Këshilli do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit	Nr. i pikëve
E dobët	0
Shumë e lartë	40

Këshilli vlerëson nëse gjyqtari respekton, miraton dhe mbështet vlerat themelore të punës

së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti, dhe i përgjigjet pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Gjyqtari duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut.

Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Gjatë marrjes së vendimeve, gjyqtarët duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre. Gjyqtarët nuk duhet të tregojnë favor apo disfavor në lidhje me çështjet, palët ose avokatët, në çështjet përpara gjykatës.

Një gjyqtar gëzon *nder dhe dinjitet* për publikun kur ai transmeton vlera personale dhe profesionale dhe konsiderohet një model për të tjerët.

Në vlerësimin e gjyqtarit dhe caktimin e pikëve Këshilli mund të marrë parasysh nëse burimet e vlerësimit përmbajnë informacione mbi sjellje të gjyqtarit, të tilla si:

- mungesë vëmendjeje dhe interesi për respektimin dhe dinjitetin e individëve;
- keqpërdorimi i kohës së punës, personelit dhe burimeve për qëllime private;
- përdorimi i substancave të ndaluara;

çdo sjellje dhe veprimtari tjetër që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të gjyqtarit, gjykatës dhe të sistemit të drejtësisë.

Vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimi i tyre, në mendimin e kryetarit dhe në të dhënat e raporteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. **Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit do të analizohen në mënyrë objektive duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit, të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me gjyqtarin.**

C. Paanësia e gjyqtarit (25 pikë)

Paanësia e gjyqtarit nënkupton mungesë paragjykimi në favor ose kundër palëve apo grupeve të veçanta. Këshilli do të vlerësojë këtu imunitetin ndaj çdo ndikimi ose presioni të



jashtëm, aftësinë e gjyqtarit për të shmangur një konflikt të mundshëm interesi që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanësinë e tij, si dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Gjyqtari duhet të jetë i drejtë dhe të duket si i tillë. Paraqitja dhe cilësia e drejtësisë janë thelbësore.

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (10 pikë)

Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të shmangin përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykim. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në vendimmarrjen e gjyqtarit.

Si burime vlerësimi lidhur me këtë kriter, shërbejnë dokumentet ligjorë të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

b) Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit (15 pikë)

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion. Në bazë të kësaj qasjeje, çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 15 pikëve referuar këtij kriteri. Gjatë procedurës së vlerësimit nëse konstatohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim është “tejet i lartë”, gjyqtari do të vlerësohet me pikët minimale.

Për të vendosur nëse numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është apo jo “tejet i lartë”, vlerësuesi, rast pas rasti, nuk përqendrohet vetëm në numrin e vendimeve të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit, por analizon dhe krahason edhe tregues

të tjerë të dalë nga burimet e vlerësimit, si për shembull, raportin ndërmjet kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari, me kërkesat e pranuar të palëve për përjashtimin e tij. Gjyqtari nuk penalizohet nëse para vendimit të përjashtimit, ai ka hequr dorë paraprakisht nga gjykimi i çështjes, por kërkesa e tij nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	Nr. i pikëve
Tejet i lartë	3
I pakonsiderueshëm	15

Vlerësuesi përqendrohet në të dhënat statistikore, vlerësimin e kryer nga gjyqtari dhe mendimin e kryetarit.

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të gjyqtarit që detajohet në treguesit e mëposhtëm.

A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)

Gjyqtari duhet të jetë në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive. Aftësitë e komunikimit efektiv përfshijnë aftësinë për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Qartësia dhe transparenca e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë vlerësimi i gjyqtarit, mendimi i kryetarit, dokumentet ligjorë të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.



b) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)

Gjyqtari duhet të tregojë kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit, siç mund të jenë çështjet me të mitur, ato të dhunës në familje etj. Pikëzimi i këtij treguesi behet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar që gjyqtari i gëzon cilësi të tilla. Çdo gjyqtar e fillon pikëzimin me 15 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Respektimi i konfidencialitetit	Nr. i pikëve
I dobët	3
Mesatar	9
I lartë	15

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë vlerësimi i gjyqtarit, mendimi i kryetarit, dokumentet ligjorë të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.

B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)

a) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (15 pikë)

Gjyqtari duhet të ketë aftësinë dhe disponibilitetin për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje. Gjyqtari duhet të kontribuojë në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njësuere, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore. Gjyqtari duhet të tregojë gatishmëri për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë vlerësimi i kryer nga gjyqtari, mendimi i kryetarit, dhe të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

b) Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore (10 pikë)

Gjyqtarët e të gjitha niveleve ndërveprojnë rregullisht me personelin e gjykatës. Nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me stafin e gjykatës krijon një ambient pune harmonik dhe produktiv. Këshilli do të vlerësojë nëse nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi shfaqjen e mungesës së respektit ndaj punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin progresiv dhe sistematik të tyre, nëpërmjet përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm, thashethemeve, përjashtimit social etj.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues shërbejnë vlerësimi i kryer nga gjyqtari, mendimi i kryetarit, të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë)

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi gjyqtarit t'i kushtojë kohë vetë-përmirësimit në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinės. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnime që nxitin



specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Pjesëmarrja e gjyqtarit	Nr. i pikëve	Pjesëmarrja e gjyqtarit	Nr. i pikëve
Periudha 3-vjeçare	15-120 ditë: 20 pikë <15 ose >120 ditë: 4 pikë	Periudha 5-vjeçare	30-200 ditë: 20 pikë <30 ose >200 ditë: 4 pikë

b) Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve (5 pikë)

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin gatishmërinë e tij për të kontribuar si gjyqtar udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me

veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

Burim vlerësimi për këtë kriter është dosja personale e gjyqtarit dhe informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari të trajnuese.

c) Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata (5 pikë)

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e eficientës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

Si burime për pikëzimin shërbejnë vlerësimi i kryer nga gjyqtari, mendimi i kryetarit, të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit, si dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit.

**ç) Publikimet ligjore akademike (5 pikë)**

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. 1 deri 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen: artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Si burim vlerësimi shërbejnë dosja personale e gjyqtarit dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij, të cilat japin të dhëna për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e punimeve dhe publikimeve ligjore akademike.

BURIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i gjyqtarëve bazohet në këto burime:

- a) dosjen personale të gjyqtarit;
- b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90, të këtij ligji;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara;
- ç) vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe vendimet gjyqësore të përzgjedhura prej tij;
- d) mendimi i kryetarit;
- dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit;

e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese;

ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj gjyqtarit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;

g) kundërshtimet e gjyqtarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;

gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë